



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr.2669, datë 11.02.2016

për

Shqyrtimin e Ankimit administrativ të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. për: “Revokimin e pjesshëm të VKD nr. 2662 datë 28.12.2015, për pjesën që ka përcaktuar të drejtën e parablerjes, vlerën minimale prej 1.044.000 Euro për bllok prej 2x5MHz dhe lejimin e pagesave me këste”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Sara Reçi, në mbledhjen e datës 11.02.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e Ankimit administrativ të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. për: “Revokimin e pjesshëm të VKD nr. 2662 datë 28.12.2015, për pjesën që ka përcaktuar të drejtën e parablerjes, vlerën minimale prej 1.044.000 Euro për bllok prej 2x5MHz dhe lejimin e pagesave me këste”.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”.
2. Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);
3. Vendimi Nr. 1252, datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar.

4. VKM Nr. 635, datë 15.07.2015 “Për disa shtesa në Vendimin Nr. 1252, datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar.
5. VKD nr. 2662, datë 28.12.2015 për “Miratimin e dokumentit të Tenderit Publik me Procedurë të Hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1970 – 1980 MHz çiftuar me 2160- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz” dhe Njoftimin për Tender Publik, Ref.2-2x5+5-2016”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Shkresa e Vodafone Albania sh.a. me Referencë: LRD/0011/OX datë 28.01.2016 (Prot. i AKEP nr.212, datë 28.01.2016) me lëndë: Ankim administrativ ndaj VKD nr. 2662 datë 28.12.2015.
2. Relacioni përkatës;
3. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
4. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP me Vendimin nr. Nr.2662, datë 28.12.2015 ka miratuar Dokumentin e Tenderit Publik me Procedurë të Hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1970 – 1980 MHz çiftuar me 2160- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz” dhe Njoftimin për Tender Publik, Ref.2-2x5+5-2016.

Ky vendim, i mbështetur dhe argumentuar ligjërisht nga AKEP ka vijuar me miratimin e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike:

- a) të numrit të autorizimeve individuale,
- b) vlerën minimale për dhënien e tyre,
- c) procedurën e konkurrimit publik
- d) dhe kriteret e vlerësimit të përcjella me:
 - Dokumentin - Shkresa Nr. 5789/1 Prot., datë 16.12.2015, (Prot. i AKEP: 1700/14, datë 16.12.2015) e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, “Përgjigje tuajës Nr.1700/13 Prot., datë 27.11.2015. “Dërgohet propozim për kufizimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezit 1900-1980 MHz dhe 2500-2690 MHz për procedurën e konkurrimit publik, numrin e autorizimeve individuale, kriteret e vlerësimit dhe çmimin minimal për dhënien e tyre””.
2. Vodafone, në ankimin e tij të përcjellë me shkresën me Referencë: LRD/0011/OX datë 28.01.2016 (Prot. i AKEP nr. 212, datë 28.01.2016) pretendon se **Vendimi i AKEP nr. 2662, datë 28.12.2015**, është një vendim në shkelje të kërkesave ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në lidhje me tre komponentë:
 - 1) të drejtën e parablerjes,
 - 2) vlerën minimale dhe
 - 3) të drejtën e pagesës me këste.

- Vodafone pretendon se:

1. **E drejta ekskluzive e parablerjes** është në shkelje të parimeve të mosdiskriminimit dhe të efikasësisë së dhënies në përdorimit të spektrit; në shkelje të standartit të trajtimit të drejtë dhe të barabartë; përbën ndihmë të ndaluar shtetërore; dhe diskriminon negativisht investimet e huaja,

dhe se

*e drejta e parablerjes, “defacto” favorizon haptazi operatorin **Plus Communication sh.a.** i cili legjitimohet ekskluzivisht për marrjen në përdorim të spektrit.*

- Siç do të shpjegohet dhe arsyetohet më poshtë, ky pretendim i Vodafone nuk qëndron sepse AKEP:

- në përmbushje të objektivave rregullatore;
- në zbatim të politikave të zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike, (Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband);
- për të nxitur konkurrencën e lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike,
- mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve broadband të komunikimeve elektronike, (rekomandimi i Autoritetit të Konkurrencës) për vendosjen e të gjithë konkurrentëve në pozita të barabarta konkurruese sa i përket licensave dhe teknologjisë, në mënyrë që të krijohen kushtet e nevojshme për funksionimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg;

Është kujdesur në respektim të kuadrit ligjor/nënligjor që,

Në Dokumentin e Tenderit (DT) të miratuar me VKD nr. 2662, datë 28.12.2015, të mos përdorë asnjë kriter pranimi ofertash apo vlerësimi me qëllim favorizimin e ndonjë ofertuesi. Në raundin e parë të vlerësimit është përcaktuar mundësia e vlerësimit të ofertave për hyrësit e rinj në tregun e komunikimeve elektronike për ofrimin e shërbimeve broadband, ose për sipërmarrës që nuk disponojnë frekuenca në këtë brez.

Pra, mundësia e paraqitjes së një ofertë në raundin e parë të vlerësimit nuk është vetëm për Plus Communication sh.a, siç pretendon Vodafone, por për çdo kandidat të mundshëm hyrës të ri në këtë brez, vendas apo i huaj.

Procedura dhe kriteret e vlerësimit, janë elementë që propozohen nga AKEP dhe përfundimisht janë të miratuara nga Ministri përkatës, dhe janë plotësisht të argumentuara.

Ju sjellim në vëmendje se, kriteret të tilla për vlerësimin e ofertave janë aplikuar edhe në procedurat e tenderimit të realizuara më parë për dhënie në përdorim të frekuencave.

- Vodafone pretendon se paracaktimi dhe e drejta e parablerjes në Tender që i jepet Plus përkundëjt operatorëve të tjerë për këtë brez specifik frekuencash (me arsyetimin se favorizohet ngaqë nuk disponon spektër në këtë brez) është e paarsyeshme dhe e pajustificuar në aspektin teknik dhe atë ekonomik.

Vodafone shprehet se Plus ka në përdorim spektër të mjaftueshëm dhe të lirë në frekuencat 900 dhe 1800 MHz, i cili mund të shfrytëzohet në çdo

kohë për çfarëdo lloj teknologjie përfshirë 3G apo 4G, pa qenë i nevojshëm ofrimi preferencial ndaj tij i spektrit në brezin 2100 MHz.

- AKEP argumenton se, ky pretendim nuk qëndron, pasi siç shpjeguar edhe më lart;
 - a) në DT nuk janë aplikuar kritere që krijojnë mundësinë e parablerjes nga ndonjë ofertues, apo te favorizojnë direkt dhe indirekt ndonjë ofertues
 - b) nuk është vetëm sipërmarrësi Plus që nuk zotëron spektër nga ky brez frekuencash.
 - c) spektri i nxjerrë për t'u dhënë në përdorim nëpërmjet kësaj procedure nuk është dedikuar për asnjë kandidat të veçantë, por është i hapur për çdo ofertues të mundshëm që do të ngrëjë sistemet IMT për ofrimin e shërbimeve broadband duke përdorur frekuencat e këtij brezi.

2. Vodafone pretendon se, çmimi referencë prej 1,044,000 Euro për bllok 5 MHz është më i ulët se çmimi referencë i shitjes së të drejtës së përdorimit të kësaj sasive spektri në Europë dhe rajon dhe është nën vlerën reale të ofertave në tregun shqiptar.

- AKEP argumenton se, ky pretendim i Vodafone nuk qëndron pasi në llogaritjen e vlerës së çmimit të propozuar për Ministrin, AKEP ka përdorur të njëjtën metodë që ka aplikuar në tenderat e mëparshëm dhe që ka rezultuar shumë e sukseshme.

Kjo metodë bazohet në:

- a. vlerat e marra si rezultat i këshillimit publik, siç e përcakton edhe ligji nr. 9918, i ndryshuar,
- b. në raportin euro/MHz/banorë rekomanduar dhe përdorur gjerësisht në vendet evropiane, e më gjerë, si dhe,
- c. në eksperiencat tona të mëparshme si dhe eksperiencat e vendeve të rajonit.

Sa më sipër, vlera minimale prej vetëm 1.044.000 Euro, nuk bien ndesh:

- a) me detyrimet e AKEP për të qasur veprimtarinë tij me praktikën më të mira europiane gjatë alokimit të spektrit,
- b) nuk çënon interesat e publikut për të maksimizuar të hyrat në buxhetin të shtetit,
- c) dhe nuk garanton një të të drejtë ekskluzive të posaçme që i jepet operatorit Plus Communication sh.a. për këtë spektër të caktuar,
- d) e si përfundim,
 - i. nuk bie ndesh me parimet bazë të Marreëveshjes së Stabilizimit Asociimit që ndalojnë favorizimin e ndërmarrjeve vendase përkundëjt investimeve të huaja.
 - ii. dhe siç theksuam edhe më lart, tenderi është i hapur si për ofertues vendas ashtu edhe të huaj.

3. Vodafone pretendon se, mundësia për pagesa me këste “de facto” i mundësohet parablerësit Plus, në kushtet kur ky lehtësim financiar nuk është zbatuar për asnjë nga tenderimet e spektrit 2100 MHz deri më sot.

- AKEP argumenton se, ky pretendim është tërësisht i pabazuar dhe nuk qëndron pasi referuar në:
 - a. përcaktimet e ligjit nr. 9918, të ndryshuar,

- b. VKM Nr. 1252, datë 10.09.2008, të ndryshuar dhe
- c. VKM Nr. 635, datë 15.7.2015,

Dhe konkretisht në Pikën 1.2.1 të VKM nr. 635, datë 15.7.2015, e cila përcakton saktësisht se :

“Aplikimi i pagesës me këste në një procedurë për dhënien e Autorizimit individual miratohet nga Ministri në momentin e dhënies së miratimit për procedurën.....”

Pra është tërësisht e qarte se nuk është kompetencë e AKEP vendosja e kriterit për aplikimin e lejitimit të pagesave me këste dhe për më tepër se, ky kriter nuk aplikohet vetëm për një kandidat ofertues, por për çdo kandidat të mundshëm në këtë procedurë.

4. Vodafone pretendon se, kushtet e DT bien ndesh me një sërë ligjesh të tjera dhe MSA, që synojnë të mbrojnë investimet e huaja, të ndalojnë ndihmën shtetërore, të promovojnë konkurrencën e ndershme, të garantojnë trajtimin e drejtë dhe të barabartë midis ndërmarrjeve ekonomike dhe është në kundërshti me marrëveshjen dypalëshe mes Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar "Për mbrojtjen e Investimeve", duke argumentuar:

- E drejta e parablerjes, kombinuar me zbatimin e pagesave me këste favorizon operatorin Plus Communication, si palë e drejtpërdrejtë e interesuar për ndryshimin e rregullave të procesit prej kohësh. Kjo praktikë e re, ndryshe nga sa është ndjekur ndaj të gjithë ofertuesve të tjerë (investitorë të huaj) që janë pajisur me spektër në këtë brez gjatë viteve të fundit përfshirë këtu Vodafone Albania, cënon parimin e trajtimit të drejtë dhe të barabartë që parashikohet në Marrëveshjen Dypalëshe të Investimeve (MDI) nënshkruar mes Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar në Mars 1994, Kushtetutën e Shqipërisë dhe Ligjin mbi Investimet e Huaja. Qendra Ndërkombetare për Zqjidhien e Mosmarrëveshjeve mbi Investimet në Washington (Arbitrazhi ICSID), forumi në të cilin ne do të depozitojmë ankesën tonë, në jurisprudencën e tij është shprehur se: "shfaqja/manifestimi minimal i padrejtësisë do të jetë e mjaftueshme për të konstatuar një shkelje të trajtimit të drejtë dhe të barabartë nga shteti pritës sipas parashikimeve të MDI", shprehet Vodafone në ankim.

➤ Sqarojmë se, AKEP, në përmbushje të objektivave rregullatore e politikave të sektorit, dhe në zbatim të ligjit nr. 9918, në të gjitha vendimmarrjet e tij ka synuar mbrojtjen e investimeve të huaja e vendase, krijimin e një tregu konkurues dhe, promovimin e një konkurrencë të ndershme, garantimin e trajtimit të drejtë dhe të barabartë të të gjithë sipërmarrësve dhe në përputhje të plotë e në zbatim të detyrimeve për fushën e komunikimeve elektronike, që rrjedhin nga traktatet e marrëveshjet ndërkombetare, ku aderon Republika e Shqipërisë. Përveç të tjerash mjafton të permendim se, të gjitha procedurat e tenderave për dhënien në përdorim të brezave 900 MHz, 1800 MHz, 2600 MHz dhe 2100 MHz, kanë qenë plotësisht të sukseshme dhe të pakontestuar.

5. Vodafone, pretendon, referuar Legjislacionit mbi ndihmën shtetërore, se, meqenëse Plus Communication është i vetmi operator i cili ende nuk disponon një brez frekuencash që i mundëson ofrimin e shërbimeve 3G, “de facto” ky është operatori i paracaktuar nga AKEP që të marrë spektrin e frekuencave dhe do të përfitojë nga pagesat me këste, çka e bën këtë akt një ndihmë të drejtpërdrejtë shtetërore që i jepet Plus Communication, duke i garantuar këtij të fundit një avantazh të padrejtë konkurrues kundrejt operatorëve të tjerë.

- Siç kemi argumentuar edhe më lart, nuk është kompetencë e AKEP vendosja e kriterit për lejimin e pagesave me këste dhe se tenderi është i hapur për çdo kandidat të mundshëm vendas apo të huaj.

6. Vodafone argumenton se, trajtimi i barabartë i shoqërive sipas legjislacionit europian, parimet baze të traktateve të BE, kërkojnë zbatimin e parimit të mosdiskriminimit, me qëllim krijimin e një tregu të brendshëm të përbashkët. Parashikimet e traktateve ndalojnë diskriminimin me bazë kombësie, parashikojnë lirinë e themelimit si dhe lirinë për ofrimin e shërbimeve. Me qëllim për të krijuar tregun e brendshëm, të gjitha politikat publike të tenderimit, duke përfshirë tenderat për spektrin, duhet të vijnë në përputhje me keto parime. Entet publike do t'i trajtojnë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim dhe do të veprojnë me transparencë.

- Sqarojmë se, AKEP, në përmbushje të objektivave rregullatorë të fushës, të gjithë kuadrin rregullator e ka pothuasje të përafëruar me atë të shumicës së vendeve anëtare të BE. Në të gjitha vendimmarrjet e tij ka bërë përpjekjet maksimale për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë operatorët, asnjëanës, transparent dhe jo diskriminues, pa bërë dallim midis sipërmarrësve vendas apo të huaj, në përmbushjen me sukses të politikës së zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike. Lejimi i aplikimit të pagesave me këste nuk trajton në mënyrë preferenciale një operator vendas (Plus Communication siç pretendon Vodafone në ankim), por ai është kriteri i aplikuar për çdo palë të interesuar për marrjen e këtij spektri të frekuencave.

7. Vodafone pretendon se, vlera minimale për ofertim, kombinuar me paracaktimin e të drejtës së blerjes së spektrit (moskonkurrin), vjen në kundërshtim me praktikën e BE-së.

- Sqarojmë se, AKEP, argumentat lidhur me çmimin minimal të pranueshëm për ofertë, si dhe për pretendimin mbi të drejtën e parablerjes i ka dhënë më lart.
- Vodafone pretendon se, kushtet e DT bien ndesh dhe pengojnë, konkurrencën e lirë e cila mbrohet me Ligjin nr. 9121/2003, i ndryshuar.
- AKEP argumenton se, në këtë proces, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 9918 të ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore e rregullatore kanë qenë pjesë e procesit nëpërmjet këshillimit publik, të gjithë sipërmarrësit e interesuar përfshi edhe Vodafone, Ministri përkatës, Autoriteti i Konkurrencës i cili ka rekomanduar mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve broadband të komunikimeve elektronike, për vendosjen e të gjithë konkurrentëve në pozita të barabarta konkurruese sa i përket licensave dhe teknologjisë, në mënyrë që të krijohen kushtet e nevojshme për funksionimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Dhe, DT është hartuar pikërisht mbi këtë frymë, duke respektuar konkurrencën e lirë dhe të ndershme për të gjithë sipërmarrësit e këtij tregu dhe kandidatët ofertues.

8. Vodafone pretendon se, përfshirja e pagesës me këste, dhe ndryshimi i rregullave të garimit në mes të procesit kanë çenuar parimin e sigurisë juridike (besueshmëria dhe parashikueshmëria në masat rregullatore).

➤ AKEP, siç ka shprehur më lart, argumenton se ky pretendim nuk qëndron pasi bazuar në:

- a) përcaktimet e ligjit nr. 9918, të ndryshuar,
- b) VKM Nr. 1252, datë 10.09.2008, të ndryshuar dhe,
- c) VKM Nr. 635, datë 15.7.2015,

nuk është kompetencë e AKEP vendosja e kriterit për lejimin e pagesave me këste dhe se vendosja e këtij kriteri bazohet në përcaktimet e VKM Nr. 635, datë 15.7.2015.

9. Vodafone, në mbështetje të argumentave të tij të dhëna në ankim duke cituar si bazë ligjore:

- Nenet 118,137 e në vijim të Kodit të Procedurës Administrative;
- Nenet 7, 62, 65, 66, 67 të Ligji Nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë";
- Neni 50,70,71 të MSA (Marrëveshja e Stabilizim Asociimit);
- Neni 4 i Ligji Nr.9375 datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore";
- Neni 70 i Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës",

Kërkon:

1. Pranimin e Ankimit Administrativ;
2. Revokimin e pjesshëm të VKD nr. 2662 datë 28.12.2015 (VKD nr. 2662) me anë të së cilit AKEP ka miratuar dokumentin e Tenderit Publik me Procedurë të Hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1970 - 1980 MHz çiftuar me 2160- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 - 1920 MHz" (DT) dhe Njoftimin për Tender Publik, Ref.2-2x5+5-2016, për pjesën që ka përcaktuar të drejtën e parablerjes, vlerën minimale prej 1.044.000 Euro për bllok prej 2x5MHz dhe lejimin e pagesave me këste.

➤ AKEP, në zbatim të Vendimit Nr. 1252, datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, Kreu IV, Procedurat e rishikimit administrativ, paragrafi "1.2 - Ankesa paraqitet pranë Këshillit Drejtues të AKEP brenda 5 ditëve pune nga data kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij vendimi" sqaron se, vendimi për të cilin ankohet Vodafone, VKD nr. 2662 datë 28.12.2015, është publikuar më datë 29.12.2016, në faqen elektronike të AKEP www.akep.al, në faqen elektronike të autoriteteve rregullatore të rajonit www.ceerwg.net, dhe në gazetata kombëtare. Ankimi i Vodafone, pavarësisht se, nuk citon si bazë ligjore VKM nr. 1252, në respektim të bazës ligjore të procedurës së parashikuar në këtë VKM, është në tejkalim të afateve procedurale të ankimit.

Bazuar në arësyetimet, argumentat dhe përfundimet e mësipërme, AKEP e konsideron kërkesën dhe pretendimet e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. për revokimin e pjesshëm të VKD nr. 2662 datë 28.12.2015, për pjesën që ka përcaktuar të drejtën e parablerjes, vlerën minimale prej 1.044.000 Euro, për bllok prej 2x5MHz, dhe lejimin e pagesave me këste të pambështetur ligjërisht,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në sa më sipër, dhe në kompetencat që i janë dhënë nga:

1. Ligji Nr.8485 dt 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”;
2. Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, për ”Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Rrëzimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. për revokimin e pjesshëm të VKD nr. 2662, datë 28.12.2015, depozituar në AKEP me anë të shkresës nr. 212 Prot. datë 28.01.2016.
2. Lënien në fuqi të Vendimit Nr. 2662, datë 28.12.2015 për miratimin e Dokumentit të Tenderit Publik me Procedurë të Hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1970 – 1980 MHz çiftuar me 2160- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz” dhe Njoftimin për Tender Publik, Ref.2-2x5+5-2016.
3. Të njoftohet Vodafone Albania sh.a. për këtë Vendim;
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____